



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M
Nr. 78, date 21.12.2017

**PËR PLOTËSIM VAKANCE DHE DHËNIEN E MANDATIT TË ANËTARIT
TË KËSHILLIT BASHKIAK, Znj. PRANDVERA VUKELAJ**

Në mbështetje të neneve 49 pika 1, 54 shkronja "j", 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 164 pika 2 e Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, vendimit nr. 962, date 28.07.2015 të KQZ-së "Për shpërndarjen e mandateve për Këshillin e Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015", VKB Nr. 61, datë 30.10.2017 "Për mbarimin para kohe të mandatit të këshilltarit bashkiak z. Preng Luli", nr. 6066 prot, datë 7.12.2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit", listës shumemërore "Për kandidatët për këshillin bashkiak Shkodër për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015" të subjektit Partia Demokristiane, Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e datës 21.12.2017, me propozim të komisionit të mandateve,

V E N D O S I

1. Plotësimin e vakancës dhe miratimin e dhënies së mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak Shkodër **znj. Prandvera Martin Vukelaj**, si kandidate e radhës me numër rendor 2, në listën shumemërore të Partisë Demokristiane "Për anëtarë të këshillit bashkiak Shkodër, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sekretari i këshillit bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 21.12.2017
Shpallur në datën 21.12.2017

Sekretar i këshillit

Suel Hadri



KRYETAR

Xhemal BUSHATI